

ÇFARË PËRFAQËSON?

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e riorganizuar, mban të njëjtin emërtim pas datës 01.07.2023.

Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër, ndërpresin veprimtarinë më datë 30.06.2023.

CILAT JANË KOMPETENCAT?

- Gjykata Administrative e Shkallës së Tiranë, e riorganizuar, ushtron veprimtarinë gjyqësore e administrative me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.

Çfarë janë Zyrat e Shërbimit?

Zyrat e Shërbimeve Durrës, Korçë dhe Shkodër ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave të ish-Gjykatave Administrative Durrës, Korçë dhe Shkodër, të riorganizuar, për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

CILAT JANË ORGANET E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR?

- Këshilli i Gjykatës
- Kryetari/
Zëvendëskryetari
- Kancelari

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Korçë dhe Shkodër deri në datën 30.06.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar.

ÇËSHTJET GJYQËSORE NUK RINDAHEN ME SHORT

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk i nënshtrohen rindarjes me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto çështje vijnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

Adresa e Gjykatës:

Rruga "Ibrahim Pashë
Bushatlliu", 1001,
Tiranë.

Kontakte:

Email:
info.administrativetirana@gjykata.gov.al

Tel:04 244 7088